

SHTOJCA 3**Formulari i kërkesës për vazhdimin e lejes mjedisore**



Emri i kompanisë	Ndermarrje Ndërtimore “NARTEL EXIN” SH.P.K.
Lloji i veprimtarisë	Thermim dhe seperim i Gurit Gelqeror në Fushë Kosovë
Vendi/Lokacioni ku zhvillon Veprimtarinë	Fushë Kosovë
Emri, mbiemri dhe nënshkrimi i personit përgjegjës i kompanisë	Sami Mehmeti
Adresa	Rruga Shefqet Shkupi, Blloku B6, Lamella 1, Lokali 4, Prishtine 10000
Telefoni, fax, e-mail	+383 45 674 888; +383 45 793 793, info@nartelxin.com
Emri dhe mbiemri i personit kontaktues përgjegjës për mjedis	Sami Mehmeti
Adresa	Junik
Telefoni, fax, e-mail	+383 45 674 888; +383 45 793 793, info@nartelxin.com
Numri i vendimit të Lejes Mjedisore Paraprake	Nr. 16/4287/ZSP/340/17 - dt. 21.12.2017
Përshkrimi i dokumentacionit bashkangjitur kërkesës, përfshirë numrin e protokollit të dokumentit, datën e lëshimit dhe skadimit	1. Certifikata e regjistrimit te Biznesit me nr Unik Identifikues: 810526858 2. Leja Mjedisore me nr. Nr. 16/4287/ZSP/340/17 - dt. 21.12.2017, Leja Mjedisore eshte dhene me afat prej 5 viteve dhe skadon me datë 20.12.2022, dhe Bazuar në nenin 16 të UA MMPHI Nr. 02/2022 për Leje Mjedisore duhet aplikuar dy muaj para skadimit. 3. Leja për aktivitete të Veçanta
Fatura e pagesës së tarifës për vazhdimin e Lejes Mjedisore	Po – Kosto Investive 89,500.0 0 € Tarifa 270€ * 30% = 81 €
Pesë(5) kopje fizike dhe një (1) elektronike (CD)	Po

Shtojca 2

Aplikacion për dhënien e lejes mjedisore

APLIKACION PËR DHËNJEN E LEJËS MJEDISORE		
1. TE DHËNAT E PËRGJITHSHME		
1.1. Të dhënat për Operatorin		
1.1.1.	Emri i subjektit	Ndërmarrja Ndërtimore "NARTEL EXIN" SH.P.K.
	Vendi	Fushë Kosovë
	Adresa	Rruga Shefqet Shkupi, Blloku B6, Lamella 1, Lokali 4, Prishtine 10000
	Nr. i tel./fax	+377 45 674 888; +377 45 793 793
	E-mail	info@nartelxin.com
1.1.2	Numri i regjistrimit të biznesit, data e regjistrimit	810526858
1.1.3	Personi Përgjegjës i kompanisë	Sami Mehmeti
	Nr. i tel./fax	+377 45 674 888; +377 45 793 793
	E-mail	info@nartelxin.com
1.2. Të dhënat për impiantin		
1.2.1.	Emri i impiantit	NN "NARTEL EXIN" SH.P.K.
1.2.2.	Adresa e lokacionit të impiantit	Fushë Kosovë

2. TË DHËNAT PËR LOKACIONIN E IMPIANTIT

<p>2.1.</p>	<p>Të dhënat për lokacionin ku zhvillohet veprimtaria sipas hartës së bashkangjitur</p>	<p>Lokacioni i Gurëthyesit ndodhet ne lokalitetin e Komunës së Fushë Kosovës, në rrugën rajonale Fushë Kosovë.</p>  
<p>2.2.</p>	<p>Numri kadastral i parcelës</p>	<p>Lokacioni i Gurthyesit ndodhet në pjesën e ngastrës kadastrale, nr. P-72514036-00255-0, Zona kadastrale Fushë Kosovë.</p>
<p>2.3.</p>	<p>Përshkrimi i lokacionit të gjitha objektet dhe aktivitetet e tyre në atë zonë</p>	<p>Lokacioni i bazës së Gurthyesit ne lokalitetin e komunës së Fushë Kosovës ne vendin e quajtur Nakaradë, komuna e Fushë Kosovës, ku ne afërsi kalon rruga rajonale nga Fushë Kosova për ne Obiliq. Lokacioni i Gurthyesit ndodhet në pjesën veriore te komunës së</p>

		<p>Fushë Kosovës në ngastrën kadastrale, nr. P-72514036-00255-0 Zona kadastrale Fushë Kosovë. Ne afërsi te drejtpërdrejtë ku është vendosur Gurëthyesi ka objekte banimi te cilat janë ndërtuar pas ndërtimit te gurthyesit dhe me te cilat nuk kemi pasur probleme asnjëherë.</p>
2.4.	Të dhënat lidhur me florën dhe fauna në atë lokacion	<p>Bimësia – Flora - Përbërja gjeologjike e tokës kushtet klimatike dhe relievi ndikojnë në zhvillimin e bimësisë. Në këtë pjesë kryesisht dominonë bimësia e tipit kserofit karakteristike për tipin klimës kontinental që është e përhapur në tërë Kosovën pra mbretëron bimësia gjetherënëse. Dominojnë kryesisht bimët barishtore duke mos përjashtuar edhe ato drunore si dhe ato të ultë një vjeçare, duke mos i lënë anash edhe kulturat bujqësore si, misrin, elbin, tërshëra, shume pak grurin etj. Karakteristike për këtë zonë është fitocenoza e përzier, karakteristike për lokacionin në fjalë është me rëndësi të përmendet fitocenozae shelgut. Prej bimëve barishtore me lule janë: kamomila, tërfili i egër, ai kultivuar, dredhëza e arave, sinapi i arave, ndërsa nga ato pa lule janë: tërshëra e egër, gruri i egër etj. Kryesisht bimësi i takojnë tipit kserofit që do të thotë bimë që përshtatën kushteve klimatike me ndërrime stinore. Bimët drunore kanë trup mesatarisht të zhvilluar, ku paraqesin një peizazh të bukur. Bimësia autoktonë paksa është shkatërruar, mirëpo duhet të ndërmerren hapa për rregullimin e ambientit në pjesët e mundshme ku lejohet mundësia. Marrë në përgjithësi kjo zonë është mirë e gjelbëruar dhe i jep një pamje të mirë tërë vendit. Në afërsi të zonës nuk ka bimësi të llojeve të rralla dhe të kërcënuara nga zhdukja ,ose bimë që ruhen dhe janë të mbrojtura si specie të veçanta. Mirëpo nuk kemi has edhe në ndonjë lloj endemik. Edhe pse vegjetacioni në afërsi dhe për rreth duhet të studiohet edhe më tepër dhe të vërtetohet rreziku i shkatërrimit të bimësisë.</p> <p>Bota shtazore – Fauna - Në vendin ku është e ndërtuar fabrika e SOLE KOSOVA, Komuna e Fushë Kosovës nuk ka botë shtazore e cila llogaritët se me aktivitetin punues mund të dëmtohen, pasi që ajo pjesë është ndërtuar me objekte agrobiznesi dhe njëherit vetë zhvillimi i aktivitetit të punës në këtë hapësirë do të ndikoj që ato të largohen. Po ashtu edhe vet</p>

		<p>natyra urbanë e ka bërë të vetën. Ndërsa në zonën për rreth është zhvilluar fauna që është karakteristike për bimësinë e kësaj zonë. Në bazë të studimit të terrenit dhe të dhënave kemi arritur të dimë se në këtë zonë dominon pakurizorë me ndërtim të ulët dhe kurrizorë me ndërtim të lartë. Prej tyre janë: urithi, shqarhi, minjtë e fushës, ndërsa prej parruzuarëve më të shpeshtë janë gjarpijt, hardhucat, zhapit, etj. prej shpezëve janë: bilbilat, vremqat, laraskat, qapka, qyqja etj. Prej insekteve hasen insektet krihëfortë dhe krih luspor të shpeshta janë fluturat, milingonat, thneglat etj. Mirëpo duhet të themi se për shkak të pranisë së vendbanimeve në afërsi mund të janë të pranishme edhe shtazët shtëpiake për të cilat njeriu ka nevojë. Pra nga kjo kuptojmë se në këtë rreth bota shtazore është mirë e zhvilluar dhe e llojllojshme që ka një rëndësi për tërë territorin dhe për biodiversitetin e Kosovës.</p>
2.5.	Të dhënat mbi zonat e veçanta të mbrojtura	Zona te veçanta te mbrojtura ne afërsi te lokacionit nuk ka,

3. PËRMBLEDHJE E TË DHËNAVE MBI VEPRIMTARINË

3.1. Përshkrim i aktivitetit për të cilën kërkohet Leja Mjedisore

3.1.1.	Skema e procesit teknologjik	Skema Teknologjike
3.1.2.	Përshkrim i pajisjeve dhe fazat e procesit teknologjik	<p>Përshkrimi i thërrmuesit me seperacion dhe pajimeve përcjellëse.</p> <p>Kompania “ NARTEL EXIN ” SH.P.K. Thërrmim dhe Seperim i gurit gëlqeror që përbehet nga këto pajime:</p> <p>Thërrmuesja primare me nofulla mobile (vetëlëvizëse), prodhuesi Italian dhe atij Turk , me kapacitet të thërrmimit 100 m³ /h, me kapacitet ka prodhues 70-80 m³ /h të bashkangjitur bunkerin pranues vëllim prej 20m³, dozatorin me vibrim dhe transportuesit shiritor për bartje të materialit të thërrmuar, Thërrmuesja sekondare me nofulla me kapacitet teorik 80 m³ /h dhe kapacitet prodhues 60-70 m³ /h Seperacionin (sitën vibruese e pjerrtë) mobile (vetëlëvizëse), sit vet lëvizëse dimensionet e sitës 1530x4800mm, kapaciteti i sitjes gjer ne 150 m³/h, prodhim Finlay 393 CV Siebanlage, si dhe transportuesit shiritor për transportimin e materialit të thërrmuar dhe të seperuar në deponit adekuate.</p> <p>Thërrmuesja terciare me traj me kapacitet teorik 60 m³/h, dhe kapacitet prodhues 40-50 m³/h.</p> <p>Procesi teknologjik i thërrmuesit me seperacion</p> <p>Prodhimi në thërrmuesit me seperacion bëhet në bazë të kërkesave të blerësve, në bazë të cilave bëhet edhe plani i biznesit të Kompanisë. Prodhimi në thërrmues me seperacion bazohet në prodhimin e fraksioneve për ndërtimin e rrugëve, për agregat betoni dhe agregat asfalti.</p> <p>Ne vijim po japim përshkrimin e procesit teknologjik të thërrmueses me seperacion.</p> <p>Guri gëlqeror i shkëputur me anë të lëndëve plasëse, ngarkohet ne tjetër lokacion dhe Masa e ngarkuar transportohet me kamionë të veçantë për transportimin e masës shkëmbore deri ne gurthyesin e kompanisë ne Fushë Kosovë. Gabaritet e masës së gurit gëlqeror të cilët ngarkohen në kamion nuk guxojnë të jenë ma të mëdhenj se</p>

900 x 710 mm.

Guri gëlqeror nga kamionët derdhet në bunkerin pranues (fortina) me kapacitet prej 10- m³, mandej me anë të dhënësit vibrues ushqehet thërrmuesja primare me nofulla. Transportuesi i pjerrët shiritor, sherben të mënjanoj sterilin nga masa e pastër, në këtë mënyrë bënë pastrimin e gurit gëlqeror që do të trajtohet në thërrmuesen me seperacion dhe të përgatis prodhimin për aplikim në ndërtimtari të ulët dhe të lartë.

Nga thërrmuesja primare nofullore, përmes dhënësit vibrues guri gëlqeror i thërrmuar kalon ne transportuesit shiritor, nga ku transportuesi shiritor, fraksionin +0-31mm ose +0-60mm e dërgon ne deponin adekuate, fraksioni i mbetur + 31mm ose + 60mm përmes transportuesit, dërgohet në thërrmuesen sekondare me nofulla e cila e bën thërrmimin ma të mirë të shkëmbit dhe e nxjerr madhësinë e nevojshme të fraksioneve për aplikim për prodhim te betonit dhe asfaltit. Thërrmimi i materialit në këtë thërrmuese bëhet sipas dëshirës nga se ka mundësi të rregullimit (për këtë operacion do të jetë e pajisur me mekanizëm të veçantë) prandaj edhe lehët nxirren fraksionet e dëshiruara.

Nga kjo thërrmuese me anë të transportuesit, materiali transportohet në sitën, ku bëhet ndarja në fraksione sipas kërkesave të blerësve. Në sitë sigurisht se mbetet një sasi e cila kalon kufijtë e të kërkuarës (do me than se madhësia e një pjese të kokrrave të fraksionit është më e madhe se vrimat e sitës), prandaj kjo sasi e materialit do të kthehet përsëri me anë të transportuesit, në thërrmuesen sekondare, ku do të bihet në madhësi të fraksioneve të lejuara, dhe kështu e përgatitur se bashku me materialin tjetër me transportier, kthehet në sitën, për trajtim të dytë, e po qe se ka nevojë (ajo në mënyrë kontinuale) do të kthehet edhe herëve tjera në thërrmuesen sekondare gjerë sa të fitohet madhësia e fraksioneve që do të kalojnë nëpër rrjeta të sitës. Materiali i trajtuar në sitë, me anë të transportuesve shiritor, transportohet në deponit e caktuara për fraksione adekuate. Materiali i seperuar 31.5 mm transportohet ne thërrmuesen terciare me traj. Materiali i thërrmuar

		<p>përmes transportuesit shiritor te pjerrët dërgohet ne siten vibruese me katër sita, fraksioni i prodhuar 0-4 mm përmes shiritit transportues transportohet ne depon adekuate për këtë lloj fraksioni. Menaxhimi i procesit teknologjik bëhet nga dhoma afër thërrmueses e në të cilën është vendosur ormani me tërë automatiken dhe mbrojtësit për tërë hargjuesit e energjisë elektrike, si dhe pulti komandues i cili është i vendosur në ormanin adekuat të caktuar për te.</p> <p>Automatika është e rregulluar në atë mënyrë që mundëson lëshuarjen në punë të pajimeve të gurthyesit me seperacion në mënyrë automatike dhe manuale. Në pultin komandues ekziston rregullatori komandues për zgjedhjen e punës së gurthyesit me seperacion.</p> <p>Te ndalesa e pajimeve të gurthyesit me seperacion në mënyrë automatike, pajimet ndalen me radhë në anën e kundërt të lëshimit të pajimeve duke filluar nga dhënësi vibrues e tutje. Te zgjedhja e punës në mënyrë manuale, pajimet lëshohen në punë secila në vete, përmes tastereve të veçanta, sipas zgjedhjes ton, gjithashtu edhe te komanda manuale duhet respektuar radhën, e lëshimit të pajimeve në punë, sikurse të mënyra automatike. Udhëheqja manuale preferohet vetëm në raste të defekteve, dhe në raste të remontit të pajimeve.</p> <p>Te gjitha pajisjet ne gurëthyes aktivizohen me ane te energjisë elektrike.</p>
3.1.3.	Numri i orëve të punës dhe ditëve të punës gjatë javës për kryerjen e aktiviteteve	8 ore x 6 dit 48 ore ne javë orari punës prej orës 08 deri 16.
3.1.4.	Kapaciteti i projektuar dhe kapaciteti i realizuar, ditor, mujor, vjetor	Sa i përket prodhimit maksimal të projektuar tek: Kapacitet të thërrmimit 100 m ³ /h, me kapacitet ka prodhues 70-80 m ³ /h
3.1.5.	Të dhënat për shfrytëzimin e lëndës së parë dhe lendeve ndihmëse.	<ul style="list-style-type: none"> • Agregati • fraksionet +0 - 4mm + 4 - 8mm + 0 - 16 mm , 0 -32 mm, 0-60 mm.

3.1.6.	Lista e rezervuarv e dhe kapaciteti i tyre	Kompania “Nartel Exin” SH.P.K.Fushë Kosovë, Thërrmim dhe seperim i Gurit Gëlqeror , nuk ka rezervuar për deponimin e naftës sepse kompania e ka afer piken e karburantit në pronësi të saj ku I bënë rregullimin dhe kontrollin teknike e te gjitha makinerive
3.1.7.	Lista e legjislacionit në fuqi	<p>Lista e Ligjeve, udhëzimeve dhe rregulloreve:</p> <p>Për plotësimin e formularit për Leje Mjedisore për kompaninë “NARTEL EXIN” SHPK, Thërrmim dhe seperim i Gurit Gëlqeror në Fushë Kosovë janë shfrytëzuar:</p> <p>- Ligjet</p> <ul style="list-style-type: none"> • Ligji për Mbrojtjen e Mjedisit Nr. 03/L-025 • Ligji për Mbeturina Nr. 04/L-060 • Ligji për mbrojtjen e ajrit nga ndotja Nr. 03/L-160 • Ligji për mbrojtjen nga Zhurma Nr. 02/L-102 • Ligji për mbrojtjen nga zjarri Nr. 02/L-41 • Ligji për mbrojtjen e natyrës Nr.03/L-233 • Ligji për ujërat e Kosovës Nr. 04/L-147 • Ligji Nr. 02/L-26 për Tokën Bujqësore <p>Udhëzimet Administrative:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Udhëzimi Administrativ (MMPHI) Nr.01/2025 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Udhëzimit Administrativ MMPHI – Nr. 04/2022 për Leje Mjedisore, • Udhëzim Administrativ nr.04/2022 për Leje Mjedisore • Udhëzimi administrativ- nr. 13/2013 Për katalogun Shtetëror të mbeturinave • Udhëzimit Administrativ nr. 06/2007 mbi rregullat dhe normat e shkarkimeve ne ajër nga burimet e palëvizshme të ndotjes.

3.2. Menaxhimi i Mbrojtjes së Mjedisit

3.2.1	Sistemi menaxhues i mbrojtjes së Mjedisit	<p>“NARTEL EXIN” SH.P.K. Thërrmim dhe seperim i Gurit Gëlqeror në Fushë Kosovë është e përkushtuar më të gjitha funksionet esajë organizative në përmirësimet e vazhdueshme që të përmbushë të gjitha detyrimet ligjore për të pasur një Mjedistë pastër dhe të qëndrueshëm.</p> <p>Sistemet e Menaxhimit Mjedisor bazuar në ISO 14001 japin mundësinë e identifikimit, vlerësimit dhe menaxhimit të aspekteve mjedisore të një organizate me synim:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Respektimin e legjislacionit vendor • Përmirësimin e komunikimit me autoritetet • Parandalimin e dëmtimit të Mjedisit • Përmirësimin e vazhdueshëm i Mjedisit
3.2.2	Raportimi	

4. AJRI DHE NDRYSHIMET KLIMATIKE

4.1.	Pikat e burimit të emisioneve ematerieve ndotëse	<p>Gjatë funksionimit kontinuel të Kompanisë “NARTEL EXIN” SH.P.K. Thërrmim dhe seperim i Gurit Gëlqeror në Fushë Kosovë ndotja e ajrit vjen nga qarkullimet e automjeteve transportuese gjate qarkullimit në parcelen e kompanisë. Gazrat nga djegiet motorike përmbajnë një numër të madh të komponentëve ndotëse me koncentracione të ndryshme por më të shprehur dhe më me ndikim në ndotje të ajrit janë CO, NOx, HxCy, SO₂ dhe Pb. Ndikimi i tyre në shkallën e ndotjes varet para se gjithash nga kushtet klimatike – meteorologjike dhe dendësisë së qarkullimit të komunikacionit në lokacionin e kompleksit për Pluhurat të cilat lirohen gjate seperimit te fraksioneve në sitat vibruese edhe pse nuk kemi pluhura te mëdha sepse seperacioni gjate gjithë kohës e pastron rërën me ujë. Pluhurat të cilat lirohen nga deponitë të cilat nevojiten për deponimin e fraksionevetë materialit të thërrmuar nuk janë të mëdha sepse pastrohen fraksionet me ujë. Pluhurat të cilat lirohen gjat ngarkimit dhe</p>
------	--	---

		<p>transportimit të fraksionve ne automjetet tranportuese. Pluhrat të cilat lirohen nga rrugët jo të asfaltuara dhe siperfaqeve operacionale që ndodhen Brenda siperfaqes manipuluese të kompanisë. Ndotje e mjedisit ndodh, gjat procesit të transportit të rërës dhe zhavorit sepse gjate seperimit nuk kemi pluhura të mëdha sepse gjate gjith kohës. Duke i marruar parasysht përqendrimet e ndotësve te cilat emitohen në lokacionin e kompleksit të Gurëthyesit mund të përfundohet se ndotja e ajrit është me përmasa nën përqendrimet e lejuara dhe janë lehte të kontrollohen.</p>
4.2.	Ndikimi i materieve ndotëse në cilësinë e ajrit	<p>Ndikimet në ajër: Gjatë realizimit të procesit teknologjik të Gurëthyesit, nga qarkullimet e automjeteve v'ie deri te rritja e ndotjes së ajrit nga emisioni i gazrave nga automjetet dhe nga avullimi i karburanteve.</p> <p>Gazrat nga djegiet motorike përmbajnë një numër të madh të komponentëve ndotëse me koncentracione të ndryshme por më të shprehur dhe më me ndikim në ndotje të ajrit janë CO, NOx, HxCy, SO₂ dhe Pb.</p> <p>Ndikimi i tyre në shkallën e ndotjes varet para se gjithash nga kushtet klimatike – meteorologjike dhe dendësisë së qarkullimit të komunikacionit në lokacionin ku është ndërtuar baza e gurëthyesit.</p> <p>Në aktivitetin e prodhimit të zhavorrit nga gurëthyesi, ndikime negative paraqiten në ajr dhe atë:</p> <p>Gurëthyesi - ndikimet në ajër vijnë nga:</p> <ul style="list-style-type: none"> ❖ Gazrat nga djegiet motorike përmbajnë një numër të madh të komponentëve ndotëse me koncentracione të ndryshme por më të shprehur dhe më me ndikim në ndotje të ajrit janë CO, NOx, HxCy, SO₂ dhe Pb. ❖ Pluhurat të cilët lirohen nga deponit të cilat nevojitenpër deponimin e fraksioneve të materialit.

		<ul style="list-style-type: none">❖ Pluhurat të cilët lirohen gjatë transportit të fraksioneve në të gjithë shiritat transportues. Pluhurat të cilët lirohen nga mekanizmi ngarkues i fraksioneve në automjetet transportuese.❖ Pluhurat të cilët lirohen nga rrugët jo të asfaltuara dhe sipërfaqet operationale që ndodhën në afërsi të gurëthyesit me seperacion❖ Ndotja e ajrit ndodhë nga gazrat të cilët lirohen nga automjetet transportuese, që nevojiten për❖ transportimin e fraksioneve të agregatit,
--	--	---

4.3.	Burimet difuzive të emisioneve të materieve ndotëse	<p>Burimet difuzive të emisioneve të materieve ndotëse paraqiten nga pluhurat të cilët lirohen nga:</p> <ul style="list-style-type: none"> ❖ pluhurat të cilët lirohen nga deponit të cilat nevojiten për deponimin e fraksioneve të agregatit, ❖ pluhurat të cilët lirohen gjatë transportit të fraksioneve të agregatit ❖ pluhuri nga sipërfaqet manipuluese të kompleksit të gurëthyesit
4.4.	Pajisjet për trajtimin egazrave shkarkuese	<p>Kompania nuk ka vendosur pajisjet për trajtimin e gazrave shkarkuese por ajo e bënë kontrollimin e rregullt teknik të makinave që konsumojnë lëndë të lëngëta djegëse. sasi vetëm sa të bëjë rrëzimin e grimcave të pluhurit që të mos shpërndahen në mjedis kjo sasi varet nga lagështia e gurit gëlqeror I cili thërrmohet dhe seperohet. Pluhuri I cili lirohet gjatë procesit teknologjik të Gurëthyesit - Thërrmim dhe seperim i Gurit Gëlqeror nëse me instalimet e sistemit të ujit nuk mund të mënjanohet apo zvogëlohet gjer në kufijtë e lejuar e cilanuk do të këtë ndikime të mëdha për mjedisin duhet të shiritat transportues e posaçërisht shiritat transportues që transportojnë fraksione të imta duhet të mbulohen dhe në vend të fraksioneve duhet të ndërtohen hinkat. Pluhuri i cili lirohet gjatë procesit teknologjik me instalimin e sistemit të ujit dhe masat e lartcekura nuk mund të mënjanohet apo zvogëlohet gjer në kufijtë e lejuar që nuk do të këtë ndikime të mëdha për mjedisin, kompania duhet të instalim e sistemit të depluhurimit me anë të filtreve që është sistem i avancuar për zvogëlimin e pluhurit.</p>

4.5.	Pajisjet për de-pluhurim	Sipas kërkesës është vendosur pajisja për de-pluhurim
4.6.	Monitorimi i emisioneve	Kompania NARTEL EXIN Sh.p.k., nuk e bënë monitorimin e emisioneve
4.7.	Monitorimi i Emisioneve /cilësisë së ajrit	Kompania "NARTEL EXIN" SH.P.K. Fushë Kosovë Thërrmim dhe seperim i Gurit Gëlqeror, nuk bënë kontroll dhe matjet e emisioneve
4.8.	Raportimet	

4.9.	Masat për zvogëlimin e ndotjes së ajrit	Gazrat nga djegiet motorike përmbajnë një numër të madhtë komponentëve ndotëse me koncentracione të ndryshme por më të shprehur dhe më me ndikim në ndotje të ajrit janë CO, NO _x , HxCy, SO ₂ , pluhuri
4.10	Masat për zvogëlimin e ndikimeve në ndryshimet klimatike	<ul style="list-style-type: none"> • Përdorimi i pajisjeve dhe makinerive me efikasitet të lartë energjetik dhe mirëmbajtja e rregullt e tyre për të ulur emetimet e gazrave serrë. • Lagia periodike e materialit dhe rrugëve të brendshme për reduktimin e pluhurit dhe përmirësimin e cilësisë së ajrit. • Organizimi i transportit dhe optimizimi i lëvizjes së automjeteve për të zvogëluar konsumin e karburanteve dhe emetimet e CO₂. • Gjelbërimi i hapësirave përreth me mbjellje të vegjetacionit për të përmirësuar mikroklimën dhe për të reduktuar ndikimet negative në mjedis. • Menaxhimi i rregullt i mbeturinave dhe shmangia e djegies së tyre në hapësira të hapura.

5. UJI

5.1.	Të dhënat për shfrytëzimin e ujit	<p>Rrezik potencial për ndotjen e ujërave sipërfaqësore dhe nëntokësore është nëse v'ie nga te reshurat atmosferike te cilat gjate rrjedhjes se tyre në punishte munde te jen tendikuara nga material te ndotura dhe te njëjta te ngritin papastërtinë e ujërave sipërfaqësore dhe nëntokësore. Ne punishte te Gurëthyesit, ujërat nga tereshurat atmosferike orientohen në pusët sedimentuese nga kanali i hapur natyror qe mos te jenë te akumuluar në hapësirën e Kompanisë NARTEL EXIN Sh.p.k..</p> <p>Ndikime negative në ujë gjatë realizimit të procesit teknologjik janë:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Nga derivatet dhe vajrat e ndryshme të cilat derdhen në tokë nga makinat të cekura në pasuset e më sipërm të cilat me derdhjen e tyre në tokë ndikojnë në ndotjen e ujërave sipërfaqësore me rastin e të reshurave atmosferike si dhe në ndotjen e ujërave nëntokësore - Mbeturinat e ngurta dhe të lëngëta të cilat krijohen gjatë mirëmbajtjes dhe riparimeve të pajimeve dhe stabilimenteve prodhuese.
------	-----------------------------------	--

		<ul style="list-style-type: none"> - Pluhuri i cili bartet me anë të ujërave sipërfaqësor. - Nga ujërat e zeza. - Mbeturinat e ngurta të cilat krijohen gjatë procesit të mirëmbajtjes të makinave ngarkuese dhe transportuese. <p>Nga vajrat dhe lubrifikantët e ndryshëm që derdhën nga pajimet dhe stabilimentet prodhuese si dhe nga mirëmbajtja dhe riparimi i tyre.</p>
--	--	--

5.2.	Të dhënat për shkarkimin e ujërave, shkarkimet e ujerave sipërfaqësorë apo në rrjetin e kanalizimit	Shkarkimi i ujerave nga Gurëthyesi, behet ne sedimentuesin e ndërtuar nga kompania po ashtu edhe ujerat atmosferike përmes kanaleve shkarkohen ne sedimentues ku pas trajtimit këto ujera përdoren përsëri për pastrimin e sipërfaqeve manipuluese te kompanisë. Ndërsa shkarkimi i ujerave nga punëtorët behet ne rrjetin e kanalizimit te fshatit.
5.3.	Ndikimet në ujë	Derdhja eventuale e derivateve si nafta, vajrat e ndryshme do të ndikojnë në ujërat sipërfaqësore dhe nëntokësore.
5.4.	Emisionet e ujërave të ndotura - treguesi i emisioneve kryesor	Në kompaninë “NARTEL EXIN” SH.P.K.Fushë Kosovë, Gurëthyes, nuk gjeneron ndotje serioze të ujërave sipërfaqësore e pastaj edhe të ujërave nëntokësore, pasi qe ndërrimin e vajrave nuk e bënë brenda kompleksit por në autoservis andaj edhe nuk ka emisione të ujërave tëndotura.
5.5	Trajtimi i ujërave tëndotura	Në kompaninë “NARTEL EXIN” SH.P.K.gurëthyes nuk gjeneron ndotje serioze të ujërave sipërfaqësore dhe pastaj edhe të ujërave nëntokësore, por ndotja ndodhe si që e kemi përshkruar ne pikat e mësipërme ne hapësirat punuese të Gurëthyesit janë te ndërtuar kanalet për grumbullimin për bartjen e ujërave nga të reshurat atmosferike nga tëra sipërfaqet. Ujerat e grumbulluar nga sipërfaqet e lart cekura nuk dërgohen për trajtim në seperatorin për pastrimin e ujërave të ndotur me grimca të ngurta dhe me vajra e yndyra të ndryshme sepse nuk kemi vajra pasi qe mirëmbajtjen e pajisjeve dhe ndërrimi i vajrave operatori nuk e bene brenda ne kompleks por jashtë kompleksit. Kanalet duhet rregullisht të pastrohen. Po ashtu edhe ujerat e shkarkuara nga pastrimi i makinerive trajtohen ne sedimentues.

5.6.	Kontrolli dhe matjet	Nga funksionimi i Kompanisë “NARTEL EXIN” SH.P.K.Fushë Kosovë nuk gjëndërohen ndotje serioze të ujërave sipërfaqësore dhe të ujërave nëntokësore. Riparimin e automjeteve , ndërrimin e vajit, të (bagerit, automjeteve dhe makinerive tjera e bene ne servis) bëhet në autoservisin me te afert. Ndërsa vetëm ndonjë riparim të vogla e bën në vend.
5.7.	Raportimi	Nuk raportohen analiza te ujerave
5.8.	Leje Ujore për shfrytëzim të ujit	Nuk është e nevojshme tek Gurthyesi
5.9.	Leje Ujore për shkarkimin e ujërave	Nuk është e nevojshme tek Gurthyesi
5.10.	Masat për zvogëlimin e ndotjes së ujërave	Duhet pastruar kanalet rregullisht, pastrimi i sedimentuesit sipas nevojës, trajtimi dhe ndërrimi i vajit për makineritë duhet te behet ne servise adekuate dhe jo ne punishte.

6. ZHURMA

6.1.	Burimet	Në domenin e mbrojtjes së mjedisit zhurma paraqet një faktor me rëndësi hapësinore e cila ka ndikim të madh në dëmtimin e të dëgjuarit, në sistemin e nervor, në hipertension, në koncentrimin e njeriut në punë etj. Lokacioni ku është i vendosur gurthyesi i kompanisë “NARTEL EXIN” SH.P.K. është i ekspozuar zhurmës së krijuar nga faktorët e ndryshëm si: Automjeteve transportuese, gjeneratori, makinat punuese, lëvizja e automjeteve ne afërsi te kompanisë.
6.2.	Kontrolli dhe matjet	Gjatë fazës së punimit v’ie deri te ngritja e përkohshme e zhurmës nga funksionimi i automjeteve transportues dhe mekanizmave ndërtimore. Si pasojë e lëvizjes së automjeteve, bagerave, autocisterneve mundë të v’ie deri te ngritja e zhurmës. Duhet të bëhen matjet e zhurmës në përputhje me ligjet dhe rregullat mbi mbrojtjen nga zhurma. Matjet duhet bërë në afërsi të objekteve të banimit. Për vlerësimin e rezultateve të fituara nga matjet duhet ti krahasojmë me vlerat e lejuarame standarde për vendet ku jetojnë dhe punojnë njerëzit.
6.3.	Raportimet	Raportimi i zhurmës do te behet sipas kushteve qe do te dalin nga

		leja mjedisore, do te behet matja dhe do te raportohet ne MMPHI.
--	--	--

7. TOKA		
7.1.	Ndikimet në tokë	<p>Gjate fazës së funksionimit të Gurthyesit, ne vendburimin e kompanisë “NARTEL EXIN” SH.P.K.në Fushë Kosovë, ndikim negative në tokë paraqitet në aspektin e degradimit të sipërfaqes së tokës, ndikim negative ne toke paraqitet nga mbeturinat e ngurta, prishja e pejsazhit , ndotja e dheut është si pasoje e sedimentimit të ndotjeve që sjellën përmes ujërave sipërfaqësore qe vine nga sipërfaqet e kompleksit të kompanisë “NARTEL EXIN” SH.P.K.dhe nga fundrrimet e komponentëve ndotëse nga ajri. Ndotja aksidentale e dheute cila vije si pasoje e avarive të mëdha apo edhe të vogla.</p> <ul style="list-style-type: none"> - Ndikim tjetër me rëndësi në tokë paraqitet depozitimi i pluhurit i cili krijohet nga proceset teknologjike të cekura në pasusin e sipërm (ndikimet në ajër), si dhe ngjeshjen e tokës të cilën e shkaktojnë makinat punuese. - Ndikimet negative nga mbeturinat e ngurta të cilat krijohen gjatë procesit të mirëmbajtjes dhe riparimeve të pajisjeve për prodhimin e fraksioneve të zhavorrit, mbeturinat e ndryshme organike dhe jo organike të cilat i krijojnë punëtorët - Ndikim tjetër me rëndësi në tokë paraqitet edhe nga deponimi i fraksioneve të agregateve si dhe depozitimi i pluhurit nga këto fraksione. <p>Ndikimet nga mbeturinat e lëngëta të cilat shkaktohen nga derdhja e vajrave dhe derivateve të ndryshëm nga mjetet punuese gjatë furnizimit dhe ndërrimit të tyre, gjatë përcitjes të gypave hidraulik të mjeteve punuese. Ndikimet nga mbeturinat e ngurta dhe lëngëta që krijohen nga larja e auto-mikserëve, dhe automjetet tjera</p>

		transportuese.
7.2.	Masat për zvogëlimin e ndikimeve në tokë	<p>Për të parandaluar e zvogëluar sasinë e ndikimeve negative në tokë Kompania ka marrë këto masa mbrojtëse:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Te gjitha ujarët atmosferike dhe ujërat e përdorura nga sipërfaqet me ndikim të mundshëm në toke grumbullohen në kolektorë dhe nëpërmjet gypave tepërcjellën në pesetën e posaçme. - Mbeturinat e ngurta komunale grumbullohen dhe vendosen në kontejner të posaçëm të pajisur me kapak për mbulim, me transport vetanak apo nëpërmjet ndërmartjeve për menaxhimin e mbeturinave, këto mbeturina të dërgohen në deponi regjionale. - Bëhet mirëmbajtja e stabilimenteve që nevojiten për realizimin e procesit për thërrmimin dhe seperimin e gurit gëlqeror.
7.3.	Përshkrimi i rehabilitimit të zonës pas përfundimit të aktivitetit	<p>Marrja e Masave Rehabilituese pas Përfundimit të Aktiviteteve të kompanisë “NARTEL EXIN” SH.P.K.</p> <p>Pas përfundimit të licencave objektet ekzistuese do të largohen nga lokacioni, bazamentet si dhe platot nga betoni duhet të shkatërrohen, imtësohen dhe të dërgohen në deponi regjionale. Të gjitha mbetjet e mbeturinave ngurta dhe ato të inerteve që ekzistojnë në sipërfaqet e lokacionit sishtrës dhe të kontaminuar pa tjetër duhet të largohen dhe të bëhet zëvendësimi, me një shtresë të humusit prej 0,5m trashësi të analizuar nga aspekti agrokimik, pastaj duhet të bëhet ngjeshja e kësaj shtrese të humusit (dheut) me qëllim që të jetë shtresa më kompakte, ashtu që të krijohet një substrat produktiv i përshtatshëm për rikultivim.</p> <p>Rikultivimi i këtyre sipërfaqeve të dëmtuara përfshin rivitalizimin në tërësi të hapësirave të dëmtuara nga realizimi i projektit. Zgjedhja e modelit të rikultivimit varet nga: Qëllimi i</p>

		<p>rekultivimit i cili nënkupton sipërfaqeve të degraduara, prapë tu kthehet funksioni i saj primar (prodhimi i biomasës), të kthehet në gjendje të përafërt me ambientin rrethues, dhe të mbjellën të lashtat periodike të cilat kultivohen ne rrethin të lokalitetit, dhe kështu zvogëlohet ndikimi negativ i këtij projekti në ekosistem.</p>
--	--	--

8. MENAXHIMI I MBETURINAVE

8.1. Përshkrimi i llojit të mbeturinave dhe klasifikimi sipas katalogut shtetëror të mbeturinave

Llojet e Mbeturinave janë:

Mbeturina të ngurta komunale grumbullohen, klasifikohen dhe të vendosen në kontejnerë të posaçëm të pajisur me kapak për mbulim me qëllim të mbrojtjes së tokës dhe ujërave nëntokësor.

Menaxhimin me vajrat mbeturinë duhet të grumbullohen dhe të vendosen në fuqi të mbyllura dhe të siguruar mirë. Kompania “NARTEL EXIN” SH.P.K., Klasifikimin dhe mënyrën e magazinimit të përkohshëm të mbeturinave e bënë në bazë të rregullave dhe kushteve të përcaktuara me Ligj të mbeturinave, Nr.04/L-060.

Sipas katalogut shtetëror kemi të bëjmë me mbeturina komunale siç janë:

Mbeturina	Emri i mbeturinës	Shkalla e rrezikshmërisë	Lloji i deponimit
15 01 01	Mbeturinat	Jo të rrezikshme	Kontejner
20 01 01	E ngurta komunale		për mbeturina
20 01 08			

Këto mbeturina vijnë nga blerja e ushqimeve dhe blerja e pajisjeve të reja të cilat janë të paketuara me qese. Kompanisë “NARTEL EXIN” SH.P.K., të ashtuquajtura mbeturina komunale deponohen në kontejner dhe pastaj bartën me kamionë nga kompanitë e licencuar, të cilat i dërgojnë në deponit regjionale për trajtim të mbeturinave.

8.2. Përshkrimi i Magazinimit apo deponimit të mbeturinave

Gjatë aktivitetit të Kompanisë “NARTEL EXIN” SH.P.K. nuk bën magazinimin e përkohshëm të mbeturinave por mbeturinat e ngurta komunale grumbullohen, klasifikohen dhe vendosen në kontejnerë të posaçëm të pajisur me kapak për mbulim.

8.3.	Përshkrimi për trajtim, përpunim dhe riciklimi të mbeturinave	Gjatë aktivitetit të Kompanisë "NARTEL EXIN" SH.P.K. nuk bëhet përpunim dhe riciklim i mbeturinave.
8.4.	Dërgimi për trajtim dhe riciklim të operatori tjetër – kontrate me kompaninë me leje përkatëse	M" "NARTEL EXIN" SH.P.K., të ashtuquajtura mbeturina komunale deponohen në kontejner dhe pastaj bartën me kamionë nga kompanitë e licencuar, të cilat i dërgojnë në deponit regjionale për trajtim të mbeturinave. Mbeturina tjera nuk gjenerohen
8.5.	Plani për menaxhimin e mbeturinave	Kompania "NARTEL EXIN" SH.P.K. nuk ka hartuar Planin për menaxhimin e mbeturinave.
8.6.	Raportimi	

9. RREZIKU NGA AKSIDENTET

9.1.	Plani për pengimin e aksidenteve ne rast të rrezikut/ plani i intervenimit të brendshëm dhe të jashtëm	Kompania “NARTEL EXIN” SH.P.K. nuk posedon rezervuar për deponim të naftës gjithashtu nuk përdor substanca të rrezikshme kështu që nuk e ka të hartuar Planin për pengimin e aksidenteve në rast të rrezikut/ plani i intervenimit të brendshëm dhe të jashtëm.
9.2.	Përdorimi i substancave të rrezikshme kimike dhe preparateve, planifikimi i masavepër zëvendësimin e tyre	Kompania “NARTEL EXIN” SH.P.K., nuk përdorë substanca të rrezikshme kimike dhe preparate.
9.3.	Masatpër parandalimin e aksidenteve dhe zvogëlimi i pasojave	<p>Për parandalimin e aksidenteve dhe zvogëlimi i pasojave Kompania “NARTEL EXIN” SH.P.K. ka marre këto masa.</p> <ul style="list-style-type: none">• Bëhet përdorim i drejt, mbikëqyrja e rregullt dhe mirë mbajtje e pajisjeve.• Kompania ka siguruar aparatet kundër zjarrit me mjete kimike si dhe enët me rërë. <p>E tërë sipërfaqja e kompleksit është e rrethuar me tel gjembor dhe ku është nevoja edhe me mur statik. Në mënyrë permanente të mirëmbahet ambienti në kompleksin e kompanisë “NARTEL EXIN” SH.P.K. – Gurthyes.</p>
9.4.	Raporti mbi gjendjen e sigurisë	Kompania “NARTEL EXIN” SH.P.K. nuk posedon ndonjë rezervuar për deponim të lëndëve djegëse si naftë apo rezervuar të gasit gjithashtu nuk përdor substanca te rrezikshme prandaj nuk e ka hartuar Raportin mbi gjendjen e sigurisë.
9.5.	Plani për mbrojtjennga zjarri	Kompania “NARTEL EXIN” SH.P.K. nuk ka hartuar ndonjë plan për mbrojtjen nga zjarri. Kompania ka siguruar aparatet kundër zjarrit me mjete kimike si dhe enët me rërë.

10. MASAT NË RASTET E PUNES JO STABILE TË IMPIANTIT

10.1.	Ndërprerja momentale e punës së impiantit	Nuk ka ndërprerja momentale të punës së impiantit
10.2.	Ndërprerja e punës	Gurëthyesi e ndërpret punën gjate sezonës së dimrit për arsye të temperaturave të ftohta.

11. NDIKIMI I MUNDSHËM I NDOTJES NË SHËNDETIN E NJERIUT

Ndikimi i mundshëm i ndotjes në shëndetin e njeriut:

Gjatë funksionimit kontinuel të kompanisë "NARTEL EXIN" SH.P.K. Gurëthyesi, në Fushë Kosovë, ndikimi i mundshëm i ndotjes në shëndetin e njeriut është shumë i vogël, sepse pike se pari kompania është e kujdesshme dhe gjithmonë i mirëmban dhe i pastron rrugët dhe sipërfaqet brenda kompleksit të kompanisë.

Personi përgjegjës për Mjedis
Emri mbiemri

Nënshkrimi

Personi përgjegjës i kompanisë
Emri mbiemri

Nënshkrimi

